



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 295/5 Prot.

Tiranë, më 24.04.2023

V E N D I M

Nr. 61, Datë 24.04.2023

Bazuar në nenin 32/1/b dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 28, datë 21.02.2023, e bërë nga organizata “Community Reporters Albania” (CRA) kundër Shoqërisë së Transportit Urban “Shpresa-Al-Transport” sh.p.k, me pretendimin për diskriminim, për shkak të “racës” dhe “moshës”, të fëmijës që i përket pakicës kombëtare rome.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues informon se: “Në një video të publikuar në rrjetet sociale¹, tregohet qartë se në datë 19.02.2023, fatorinoja i linjës urbane Kamëz-Qendër-Kamëz, ka diskriminuar fëmijën Rom i cili ishte ulur në vendin e parë të sediljes së autobuzit dhe fatorino e ka tërhequr prej veshi dhe e largon nga vendi ku ishte ulur. Ky rast për organizatën tonë tregon diskriminim racor dhe dhunë fizike ndaj të miturit rom”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe Shoqëria Shpresa-Al të kërkojë ndjesë publike për rastin dhe të marrë masa ndaj fatorinos.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “b”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat e paraqitura nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm, për çështje që lidhen me interesa kolektive.

Bazuar në dispozitën e mësipërme ligjore rezulton se, kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund t’a bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra që nuk ka një interes legjitim të drejtëpërdrejtë të vetin. Në këtë rast që kjo

¹ <https://fb.watch/iPljI7mrnc/?mibextid=NnVzG8>

palë të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit, duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të çenohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në nenin 3, pika 11, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Organizatat me interesa legjitime” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit”*.

Referuar Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me nr. 1538, datë 30.10.2020, nëpërmjet së cilit Qendra “Community Reporters Albania” (referuar me akronimin CRA) është regjistruar si person juridik, konstatohet se objekti kryesor i veprimtarisë së kësaj shoqate është mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare romë në Shqipëri.

Mbështetur në përmbajtjen e Aktit të Themelimit dhe Statutin e Qendrës, rezulton se forma e organizatës jofitimprurëse, është ajo e Qendrës, parashikuar në ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 *“Për organizatat jofitimprurëse”* dhe objekti kryesor i veprimtarisë së Qendrës është si më poshtë:

- *“Të ofrojë praktika periodike trajnimi për gazetarinë online, televizion, raportim live, montazh video, audio prodhim, web media, blog;*
- *Të kontribuojë në edukimin dhe sensibilizimin e publikut për rëndësinë e mediave në ndërtimin e ruajtjen e një demokracie ligjore dhe funksionale;*
- *Të promovojë nisma për afirmimin e të drejtave themelore të individëve dhe favorizimin e integritit mediatik dhe social të kategorive në nevojë;*
- *Të mbështesë nisma të ndryshme sociale nga komunitete dhe organizata jofitimprurëse me akses të kufizuar mediatik;*
- *Të zhvillojë dhe forcojë bashkëpunimin me partnerë, të tjera subjekte publike dhe private, institucione mediatike dhe institucione që ushtrojnë veprimtari social-kulturore apo që kanë qëllime të ngjashme dhe që i bashkon misioni dhe qëllimet;*
- *Të këshillojë institucione publike e subjekte të tjerë për çështje të hartimit të politikave të ndryshme mediatike dhe sociale;*
- *Të bashkëpunonjë me grupet identitare për përmbushjen e qëllimit;*
- *Realizimin e projekteve dhe aktiviteteve që kanë ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e integritit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane;*
- *Hulumtimin dhe dokumentimin, promovimin e kulturës dhe identitetit dhe të modeleve pozitive të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane;*
- *Bashkëpunimi me televizione të ndryshme për krijimin e organizimin e emisioneve të cilat nxisin reagimin qytetar dhe aktivizmin;*
- *Analiza mbi problematikat sociale dhe ligjore në kuadrë të nxitjes së politikave për përmirësimin e jetesës për këto minoritete Rome dhe Egjiptiane;*

- *Të krjojë raporte të ndryshme që kanë të bëjnë me median komunitare, çështje sociale dhe ligjore”.*

Në këtë kontekst, theksojmë faktin se në bazë të pikës 1, të nenit 4, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilët janë anëtarë të pakicave kombëtare Rome dhe Egjiptiane. Mbështetur në objektin e veprimtarisë së Qendrës CRA, sipërcituar në vendim, Komisioneri gjykon se Qendra, përfaqësuar nga B.Xh (Drejtor Ekzekutiv i CRA) legjitimohet dhe ka tagër për të bërë ankesë në emër të mbrojtjes së të drejtave të pakicave kombëtare Rome.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjatë shqyrtimit të kësaj anekse, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 295/1, datë 27.02.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga Shoqëria Shpresa-Al dhe nga Bashkia Kamëz, lidhur me pretendimet e palës ankuese.

Me shkresën nr. 18, datë 03.03.2023, Shoqëria Shpresa-Al, informoi Komisionerin se: “Me marrjen e ankesës nga ana jonë, janë kërkuar në rrjetet sociale pamjet e videos që referoni, në mënyrë që të kuptonim çfarë kishte ndodhur dhe kush janë personat përgjegjës për situatën në fjalë, duke qenë se deri në këtë moment nuk kishim dijeni për ngjarjen. Megjithëse i shqyrtuam disa herë pamjet që gjetëm në internet, e kemi të vështirë të identifikojmë automjetin

që pretendohet të jetë në pronësi të shoqërisë “Shpresa-Al” dhe personin (faktorin) që ka kryer veprimin përkundrejt fëmijës. Do t’ju luteshim që në rast se dispononi diçka më tepër në lidhje me rastin në fjalë, të na e vinit në dispozicion pasi do të na ndihmonte që të kryenim një verifikim të drejtë dhe të saktë të ngjarjes”.

Me shkresën nr. 1934/2, datë 31.03.2023, Bashkia Kamëz, dërgoi pranë Komisionerit përgjigjen e dhënë nga Shoqëria Shpresa-Al, në të cilën ishte dhënë i njëjti informacion si në shkresën sipërcituar, drejtuar Komisionerit.

Inspektori i çështjes, me e-mail-in datë 09.03.2023, ka informuar subjektin ankues me shkresën e dërguar nga Shoqëria Shpresa-Al.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankuesit, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Në nenin 5, pika 1, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet se: *“1. Ndalohej diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose*

procedurë, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë”.

Në Kreun IV, të LMD-së parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. LMD në nenin 20/1/a dhe b², ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një personi apo grupi personash në ofrimin e të mirave dhe shërbimeve.

Legjislacioni shqiptar përmban bazat ligjore për mbrojtje të veçantë për fëmijët dhe të rinjtë. Kështu, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 54 të saj parashikon se:

1. *“Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti”.*
2.
3. *“Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal”.*

Shteti Shqiptar është angazhuar për të respektuar të drejtat e fëmijëve, duke formalizuar vullnetin e vet përmes ratifikimit me anë të ligjit 7531, datë 11.12.1991, të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës.

Kështu në nenin 19/1 të kësaj Konvente parashikohet se: *“Shtetet Palë marrin të gjitha masat legjislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar”.*

Ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, ndalon diskriminimin që bazohet në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, pra edhe për shkak të racës dhe moshës dhe që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkuqizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

² Neni 20/1/a dhe b, të ligjit 10221/2010: *“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi...”*

Nga verifikimi i pamjeve video të transmetuar në rrjetin social: facebook.com/joqvideos, rezulton se në një autobus linje urbane, fatorinoja kap për veshi dhe ngre nga sedilja një fëmijë, i cili ishte i ulur në rreshtin e parë. Nga shikimi i pamjeve video, nuk arrihet të identifikohet asnjë element që mund të identifikojë kompaninë e transportit apo fatorinon.

Bazuar në pamjet video dhe informacionit të dhënë nga organizata CRA, Komisioneri vlerëson se dhuna e ushtruar ndaj fëmijës është një rast flagrant i shkeljes së dinjitetit të drejtave dhe lirive themelore të individit të sanksionuara dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe mosndëshkimi i një sjellje diskriminuese kaq të hapur, do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Nga analiza e provave dhe fakteve të administruara dhe informacioni i dhënë nga CRA, nuk rezulton se ngjarja ka ndodhur në linjën e transportit që administrohet nga Shoqëria Shpresa-Al, apo të identifikohet linja e transportit ku pretendohet të ketë ndodhur ngjarja.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk arriti të administronte fakte dhe prova që mbështesin pretendimin e subjektit ankues dhe në mungesë të provave, Komisioneri, arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Shoqërisë Shpresa-Al.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të fëmijës që i përket pakicës kombëtare rome, për shkak të racës dhe moshës, nga ana e Shoqërisë Shpresa-Al, në fushën e të mirave dhe shërbimeve.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA